

VENDIM
Nr. 534, datë 25.7.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 42, DATË 16.1.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE
TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE
JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i fundit, i shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet”, të rregullores që i bashkëlidhet vendimit nr. 42, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama